



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:195427

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05712821

Ac.nr.2412/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.I. nga fsh....., Komuna e Sh....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë - Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti vërtetim diskriminimi dhe kompensim i pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7184/2021, të datës 27.01.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit H.I. nga fsh....., Komuna e Sh....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7184/2021, të datës 27.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.7184/2021, të datës 27.01.2022 ka gjykuar si në vijim: **I. REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit H.I. nga fsh....., Komuna e Sh..... me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet diskriminimi ndaj paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, të ia paguaj një (1) pagë mujore neto në shumë prej 447.71 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, e **PABAZUAR. II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala paditëse përmes të autorizuarit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me

propozim që Gjykata e Apelit t'a aprovojë ankesën si të bazuar, t'a prishë aktgjykimin e atakuar dhe t'a kthej çështjen në rigjykim ose t'a ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe t'a aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe shpenzimet për ankesë në lartësinë prej 208 euro.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d) si dhe nenit 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa palës paditëse është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi H.I. nga fsh....., Komuna e Sh..... përmes avokatit të tij "Klinaku & Associates" me datën 11.08.2021 ka paraqitur padi ndaj të paditurës, për vërtetimin e diskriminimit dhe kompensimin e shpërblimi jubilar, me kamatë prej 8 % dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura jashtë seancës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.7184/2021 të datës 27.01.2022, duke vendosur që t'a refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar gjykata ka theksuar se paditësi në mes të palëve ndërgjyqëse nuk del të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 06.10.2003 pasi që kjo është vërtetuar edhe në bazë të vërtetimit të datës 08.01.2021 të lëshuar nga e paditura. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë paditësit e drejta për të kërkuar shpërblimin jubilar për 10 vite të përvojës së punës i ka lindur me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me datë 01.01.2015, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur me datë 11.08.2021 pra pas kalimit të afatit të parashkrimit si afat 3 vjeçar sipas nenit 87 të LMD-së. Në raport me kërkesëpadinë për diskriminim gjykata ka vlerësuar se meqenëse kërkesa për shpërblim jubilar është parashkruar, atëherë kërkesëpadija për diskriminim është e pa themeltë sepse baza e kërkesëpadiës për diskriminim ndaj paditësit lidhet me kërkesëpadinë për shpërblim jubilar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësoretë dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuuese, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të propozuesit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadiës, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se

si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, sepse arsyetimi i gjykatës në aktgjykimin e atakuar është në përputhje të plotë me kërkesat nga neni i cekur më lartë me të cilin përcaktohet se: “Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.”

Sa i përket pretendimeve për diskriminim, pala paditëse nuk ka arritur të bindë gjykatën se nga cila bazë ka qenë i diskriminuar paditësi, sepse shfuqizimi i ligjit, aktit nën ligjor, kalimi i kohës së vlefshmërisë së një kontrate apo marrëveshje të përgjithshme, kalimi i afatit për parashtrimin e padisë nuk mund të interpretohet si diskriminim.

Gjykata e Apelit vendimin mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pa bazuar e pranoi si të tillë, mirëpo jo nga baza e parashkrimit, por nga mungesa e bazës ligjore, pasi që paditësi 10 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2013 në kohën kur nuk ka pasur **Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive në fuqi apo ndonjë Kontratë Sektoriale** që do të parashihet një të drejtë të tillë të paditësit.

Pretendimet e tjera të palës paditëse në raport me parashkrimin dhe kohën e fillimit të rrjedhës së parashkrimit nuk janë relevante, pasi sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar sepse në kohën e arritjes së jubilesë nga ana e paditësit pra në vitin 2013 nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, sepse e njëjta ka hyrë në fuqi me 01.01.2015 deri me 31.12.2017.

Po ashtu për Gjykatën e Apelit pretendimet tjera rreth kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, vazhdimit të së njëjtës edhe për një vit, për shkak se njëra palë nuk e ka denoncuar në kohë daljen nga Marrëveshja, pasi që të njëjtat kanë qenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme me rastin e lëshimit të Mendimit Juridik mbi vlefshmërinë e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila Gjykatë në piken II të këtij mendimi ka përcaktuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e më tejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015-31.12.2017.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:195427
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05712821

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2412/2022, datë 21.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Naim Mehulli, d.v.